



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2019:267933

Datë: 17.11.2021

Numri i dokumentit: 02411046

P.nr.1012/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit I M nga fshati G. komuna e G. për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.3096/19 të datës 14.11.2019, në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me datë 15.11.2021, në praninë e Prokurores së shtetit Stojanka Kasaloviq dhe të pandehurit B. M. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 15.11.2021, përpiloi më datën 17.11.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: I. M. nga i ati L.e ëma F. e vajzërisë R. i lindur me datë ... me vendbanim në fshatin G. komuna e G. me numër personal ...veteran i luftës, i martuar, prind i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar për vepra penale.

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Me dt. 14.12.2017 rreth orës 15:00, në pyllin shoqëror që menaxhohet nga Drejtoria për ekonomi, bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural në pronësi komunale e fsh. S. – Vushtrri, në vendin e quajtur “Te Sana”, pa leje me qëllim vjedhje ka prerë dhe marrë 132 trungje dru të llojit “Shkollë”, me diametër 10-12 cm, me gjatësi 9 metra, me vëllim prej 3.96 metër³, në vlerë të dëmit prej 605.80 euro.

- **Me çka do të kryente veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.**

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar Agjencioni Pyjor i Kosovës, Sektori i Pylltarisë në Vushtrri udhëzohet në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore- juridike lidhur me këtë çështje penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr. 3096/19 të datës 14.11.2019, me të cilin ka akuzuar të pandehurin I. M. nga fshati G. komuna e G. për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, nga e cila aktakuzë është tërhequr Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2021.

Prokurorja e shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2021 ka bërë plotësimin e aktakuzës dhe atë sa i përket emrit të të pandehurit, ku në vend të emrit B. duhet të jetë emri Ibrahim, e njëjta ka deklaruar se, pasi që e kemi kuptuar nga gjykata se dëshmitari I.F., njëherit roja e pyllit, i vetmi dëshmitar okular ka vdekur dhe se i pandehuri nuk e pranon fajësinë për veprën me të cilën ngarkohet dhe duke marrë parasysh se kjo dëshmi është kyçe dhe është e vetmja dëshmi dhe të gjitha provat tjera lidhen me këtë dëshmi dhe fletëparaqitja lidhet me këtë provë, tërhiqem nga ndjekja penale e mëtutjeshme ndaj të pandehurit I. M., për veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, po ashtu, duke u bazuar në nenin 7 par. 2 të KPPK-së duke marrë parasysh se prokurori ka për detyrë të vërtetojë faktet edhe në favor të pandehurit, ka deklaruar se ka vendosur të tërhiqet nga aktakuza.

Në përputhje me nenin 454. par.1 të KPPK, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore – juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së, pasi që përfaqësuesi i palës së dëmtuar nuk kanë prezantuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.11.2021.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI **Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal** **P.nr.1012/19, datë 17.11.2021**

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.